



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 47

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 6 prill 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 54/2018, datë 29.3.2018	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar.....	2693
Vendim i Kuvendit nr. 55/2018, datë 29.3.2018	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 85/2017, “Për zgjedhjen e Byrosë dhe përbërjen e sekretariateve të Kuvendit”	2693
Vendim i Kuvendit nr. 56/2018, datë 29.3.2018	Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).....	2693
Vendim i Kuvendit nr. 57/2018, datë 29.3.2018	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 86/2017, “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar.....	2698
Vendim i Kuvendit nr. 58/2018, datë 29.3.2018	Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për realizimin e reformës zgjedhore.....	2698
Dekret i Presidentit nr. 10751, datë 3.4.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	2698
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 94, datë 27.3.2018	Mbi raportimin financiar të shoqërive të ujësjellësve në Republikën e Shqipërisë.....	2699
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 204, datë 30.3.2018	Për delegim kompetencash.....	2702
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 10, datë 3.4.2018	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2017-143, datë 21.03.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.....	2702

Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 24, datë 28.3.2018	Për disa ndryshime në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave”.....	2706
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 78, datë 5.3.2018	Për shqyrtimin e kërkesës për ndihmë shtetërore.....	2707
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 2106/1, datë 27.3.2018	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Ndërtimi i nënstacionit 110/20 kV, Gjiri i Lalëzit”, Durrës.....	2709
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 5905/3, datë 27.3.2018	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Ndërtimi i nënstacionit të ri 110/20 kV”, Velipojë.....	2710
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3791/1, datë 27.3.2018	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Ndërtimi i nënstacionit të ri 110/20 kV”, Fier.....	2710
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 2477/2, datë 3.4.2018	Për shpronësim, marrjen në përdorim të përkohshëm dhe vendosjen e servitutit të kalimit, për pasuritë e paluajtshme që preken nga projekti, “Ndërtimi i linjës së tensionit dhe faciliteteve të tjera, pjesë e projektit të gazsjellësit Trans Adriatik Pipeline (Projekti TAP) AG”, në zonat Fier, Korçë, Devoll, Berat dhe Skrapar.....	2711
Kërkesë e Ministrisë së Brendshme nr. 6867/7, datë 26.3.2018	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit: “Për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit”, në fshatin Zenisht, Bashkia Mat.....	2725
Kërkesë e Ministrisë së Brendshme nr. 6753/5, datë 30.3.2018	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit: “Ndërtim i varrezave të reja”, Bashkia Shkodër.....	2725

**VENDIM
Nr. 54/2018****PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 90/2017, “PËR
CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME
TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të neneve 21, pika 2, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

I. Deputeti Astrit Veliaj (PD) caktohet anëtar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 29.3.2018

**VENDIM
Nr. 55/2018****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 85/2017, “PËR
ZGJEDHJEN E BYROSË DHE
PËRBËRJEN E SEKRETARIATEVE
TË KUVENDIT”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, pas këshillimit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë “Lëvizja Socialiste për Integrim”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 85/2017, “Për zgjedhjen e Byrosë dhe përbërjen e sekretariateve të Kuvendit”, në pikën III bëhet ky ndryshim:

I. Deputeti Përparim Spahiu (LSI) zgjidhet anëtar i Sekretariatit për Buxhetin.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 29.3.2018

**VENDIM
Nr. 56/2018****PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS,
ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË
POZICIONEVE TË PUNËS TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP)**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pika 2, dhe 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP),

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Struktura e AKEP-it është sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur.

II. Organika e AKEP-it është sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur.

III. Numri i punonjësve është 85.


IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 29.3.2018

Lidhja nr. 1

STRUKTURA E AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP)





Lidhja nr. 2

**ORGANIKA E AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
(AKEP)**

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
I. KËSHILLI DREJTUES:		(6)
KRYETAR		1
ANËTARË		4
SEKRETAR I KËSHILLIT DREJTUES		1
II. KABINETI I KRYETARIT:		(3)
DREJTOR KABINETI	II-a	1
KËSHILLTAR	II-b	1
SEKRETAR		1
III. DREJTORIA JURIDIKE DHE INTEGRIMIT:		(10)
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I SHËRBIMEVE LIGJORE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI		
SPECIALIST	III-a	1
	III-b	2
SEKTORI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE:		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI		
SPECIALIST	III-a	1
	III-b	2
SEKTORI I INTEGRIMIT DHE MARRËDHËNIEVE PUBLIKE:		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI		
SPECIALIST	III-a	1
	III-b	2
IV. DREJTORIA TEKNIKE:		(9)
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I ADMINISTRIMIT DHE KOORDINIMIT TË SRF:		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2



SEKTORI I NUMERACIONIT, SIGURISË SË RRJETEVE, INFRASTRUKTURËS DHE IT: PËRGJEGJËS SPECIALIST	III-a III-b	(5) 1 4
V. DREJTORIA E AUTORIZIMEVE: DREJTOR SEKTORI I AUTORIZIMEVE: PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST SEKTORI I ADMINISTRIMIT Domain.al DHE KONFORMITETIT TË PAJISJEVE: SPECIALIST	II-b III-a III-b III-b	(6) 1 (3) 1 2 (2) 2
VI. DREJTORIA E MONITORIMEVE, KONTROLLIT DHE INSPEKTIMEVE: DREJTOR SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË QENDRËS KOMBËTARE DHE ZYRAVE RAJONALE TË MONITORIMIT TË SRF: PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALISTË (MONITORUES) SEKTORI I KONTROLLIT DHE INSPEKTIMIT: PËRGJEGJËS SEKTORI INSPEKTORË	II-b III-a III-b III-a III-a	(15) 1 (7) 1 6 (7) 1 6
VII. DREJTORIA E TREGJEVE DHE MASAVE RREGULLATORE: DREJTOR SEKTORI I KËRKIMEVE, ANALIZËS, TARIFAVE DHE STATISTIKAVE: PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST	II-b III-a III-b	(8) 1 (4) 1 3



SEKTORI I INTERKONEKSIONIT DHE AKSESIT: PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST	III-a III-b	(3) 1 2
VIII. DREJTORIA E TË DREJTAVE TË PËRDORUESVE: DREJTOR SEKTORI I MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË PËRDORUESVE DHE PORTABILITETIT: PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST SEKTORI I SHËRBIMIT UNIVERSAL: SPECIALIST	II-b III-a III-b III-b	(6) 1 (3) 1 2 (2) 2
IX. DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR: DREJTOR SEKTORI I BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR: PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST SEKTORI I PAGESAVE, MONITORIMIT DHE ZBATIMIT TË KONTRATAVE: PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST	II-b III-a III-b III-a III-b	(7) 1 (3) 1 2 (3) 1 2
X. DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME: DREJTOR SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE: PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST SEKTORI I PROTOKOLLIT DHE ARKIVIT: SPECIALIST SPECIALIST	II-b III-a III-b IV-a IV-b	(15) 1 (3) 1 2 (2) 1 1



SEKTORI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE:		(9)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	
PUNONJËS INFORMACIONI DHE MAGAZINIER	-	1
PUNONJËS MIRËMBAJTJEJE	-	1
SHOFER	-	1
PASTRUES	-	4
		2

NUMRI TOTAL I PUNONJËSVE: 85

**VENDIM
Nr. 57/2018**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 86/2017, “PËR
CAKTIMIN E KRYESIVE TË
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME
TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 86/2017, “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, në pikën I bëhet kjo shtesë:

I. Deputeti Bardh Spahia (PD) caktohet Zëvendëskryetar në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 29.3.2018

**VENDIM
Nr. 58/2018**

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË
VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT
TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR
REALIZIMIN E REFORMËS
ZGJEDHORE**

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore zgjatet për një periudhë 4-mujore nga data e miratimit të këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 29.3.2018

**DEKRET
Nr. 10751, datë 3.4.2018**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme, ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ministrit të Turizmit dhe Mjedisit,



DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Iballe Selim Breca (Jetishi)
2. Mentor Pashk Gecaj
3. Yusuf Hasan Tuna
4. Muhamed Salih Koçishta (Koçishta)
5. Mevluda (Mevlluda) Qerim Koçishta (Naxhak)
6. Beha Muhamed Koçishta
7. Besa Jetish Kadishani
8. Burim Rahmon Canaj
9. Fatmire Ganija Bekteshi (Mersimi)
10. Salih Ibrahim Rizvanolli
11. Adriana Pasquale Crisanti
12. Emine Rushit Sopa (Berisha)
13. Rahime Ragip Brahimaj (Gashi)
14. Gentiana Imer Aliaj (Osmani)
15. Myrvete Xhevat Kabashi (Hysenaj)
16. Herolind Sokol Bajraktari
17. Veronika Evgeniy (Jevgenij) Starodubtseva (Starodubceva)
18. Naile Misin Hasani (Veli)
19. Betim Fazli Morina
20. Anastasia Aleksandr (Alexander) Grigoryeva (Grigorjeva)
21. Dardan Ekrem Bibaj
22. Arbër Gjokë Geci
23. Jetlir Bedri Zyberaj
24. Flora Xhavid Brovina
25. Durim Alush Likaj
26. Krenar Selim Berisha
27. Ohad Michael Asor
28. Omer Gkhan Mehmet Kuyucu
29. Dallas Joseph Dexter Bernard Moore
30. Jaren Ryan Mergin Sina
31. Muqerem Jasmine Mergin Sina

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

URDHËR

Nr. 94, datë 27.3.2018

**MBI RAPORTIMIN FINANCIAR TË
SHOQËRIVE TË UJËSJELLËSVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të nenit 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 6, germa “dh”, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, si dhe të nenit 37, të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Të gjitha shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve që janë qendër qarku, brenda datës 30 maj të çdo viti, pas mbylljes së vitit ushtrimor, duhet të paraqesin një raport, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për çështjet e parashikuara sipas procedurës të përshkruar në aneksin nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Raporti përgatitet nga një auditues ligjor, shoqëri auditimi ose bashkim operatorësh ekonomikë të licencuar për auditim ligjor, në përputhje me:

- Standardin ndërkombëtar mbi shërbimet e lidhura ISRS 4400, “Angazhimet për të kryer procedurat e dakorduara në lidhje me informacionin financiar”, të shpallur nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC);

- Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël (hartuar dhe publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (IESBA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC), i cili përcakton parimet etike thelbësore për audituesit, lidhur me integritetin, objektivitetin, pavarësinë, kompetencën profesionale dhe kujdesin e duhur, konfidencialitetin, sjelljen profesionale dhe standardet teknike. Edhe pse ISRS 4400 kërkon që pavarësia nuk është kusht për angazhimet në shërbimet e dakorduara, institucioni kontraktues duhet të kërkojë që audituesi të jetë i pavarur nga i



kontraktuari dhe të jetë në pajtueshmëri me kërkesat për pavarësinë e kërkuar nga Kodi i Etikës për Profesionistët Kontabël dhe pikën 4 të këtij urdhri.

3. Raporti që do të lëshohet do të ketë natyrën e një raporti të gjetjeve faktike, të përgatitur në përputhje me standardet e pranuar të etikës, integritetit dhe kompetencave profesionale.

4. Audituesit që angazhohen në shërbimet e kryerjes së procedurave të dakorduara, sipas ISRS 4400, nuk duhet të jenë të angazhuar, në dy vitet e fundit, në shërbimet e auditimit ligjor apo në shërbimet e konsulencës financiare apo shërbimeve të kontabilitetit pranë shoqërisë së ujësjellësit ku do të realizojnë angazhimet për të kryer procedurat e dakorduara. Gjithashtu, këta auditues nuk duhet të kenë marrë asnjë masë disiplinore nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, gjatë kryerjes së angazhimeve të tyre në fushën e auditimit ligjor, konsulencës financiare dhe kontabilitetit.

5. Personeli i angazhuar nga audituesit ligjorë apo shoqëritë e auditimit nuk duhet të jenë në kushtet e konfliktit të interesit me personat e ngarkuar me drejtimin e shoqërive të ujësjellësve.

6. Audituesi ligjorë/shoqëria e auditimit duhet që të ketë eksperiencë në shërbimet e procedurave të dakordësuara. Partneri i angazhimit duhet të ketë të paktën 5 vjet që ka fituar titullin e audituesit ligjor dhe ai ose një nga personat e angazhuar në stafin e tij duhet të zotërojë titullin e audituesit të brendshëm të certifikuar për sektorin publik.

7. Kostot e shërbimit mbulohen nga shoqëritë e ujësjellësve.

8. Format i raportit përgatitet dhe miratohet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, jo më vonë se 2 javë nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

9. Ky raport përgatitet të paktën një herë në vit, me përjashtim të shoqërive të ujësjellësve në Tiranë, Vlorë, Durrës, Fier, Elbasan dhe Shkodër, të cilat për shkak të madhësisë së aktivitetit të tyre, duhet të raportojnë edhe për gjysmën e parë të vitit. Raporti për gjysmën e parë të vitit duhet të paraqitet pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë brenda datës 30 shtator.

10. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri të gjitha shoqëritë e ujësjellësve në Republikën e Shqipërisë, të parashikuara në pikën 1 të këtij urdhri, si dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

11. Ngarkohet Bordi i Mbikëqyrjes Publike për ushtrimin e kontrollit të cilësisë ndaj audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit të angazhuara në këto misione.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCEVE DHE
EKONOMISË
Arben Ahmetaj

ANEKS NR. 1
PROCEDURA MBI PARAQITJEN E
RAPORTIT TË SHOQËRIVE TË
UJËSJELLËS-KANALIZIME NË
MINISTRINË E FINANCEVE DHE
EKONOMISË

Audituesit ligjorë, shoqëritë e auditimit apo bashkimet e operatorëve ekonomikë të licencuar për auditim ligjor, në raportin me gjetjet faktike, si dhe bazuar në evidencën financiare dhe jofinanciare deri më 31 dhjetor, duhet të:

a) Krahasojnë shpenzimet faktike të vitit sipas librave kontabël me ata të buxhetuar dhe të japin shpjegime mbi diferencat;

b) Krahasojnë buxhetin fillestar të vitit me ndryshimet e kryera në këtë buxhet gjatë vitit dhe të verifikojnë miratimin e tyre;

c) Verifikojnë nëse është kryer inventari fizik i aktiveve afatgjata materiale dhe numërimi i mjeteve monetare në arkë në fund të vitit ushtrimor;

ç) Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi detyrimet e prapambetura, dhe të verifikojnë rakordimin me librat kontabël analitikë (kartelat e furnitorëve), duke analizuar ekzistencën e detyrimeve pa identitet. Në lidhje me këto detyrime, duhet të verifikohet edhe vjetërsia e tyre në: deri në 1 vit, nga 1–5 vjet dhe mbi 5 vjet, të grupuar në detyrimet ndaj:

- OSHEE-së;
- Administratës tatimore dhe doganore;
- Institucioneve buxhetore;
- Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- Punonjësve;
- Çështjeve gjyqësore;
- Të tjera detyrime, nëse janë më shumë se 10% e totalit të tyre.

Gjithashtu, audituesit ligjorë, shoqëritë e auditimit apo bashkimet e operatorëve ekonomikë



të licencuar për auditim ligjor, duhet të verifikojnë nëse ka aktmarrëveshje për shlyerjen e çdo detyrimi të prapambetur;

d) Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi planin e biznesit të përgatitur për huamarrje nga bankat (nëse ka) dhe të krahasojnë të dhënat faktike, sipas pasqyrave financiare më të fundit, duke identifikuar diferencat në rezultatin përfundimtar të *cash-flow*;

dh) Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve për tarifatat sipas kategorive: familjarë, biznese, institucione, në lidhje me çështjet si më poshtë:

- Furnizimit me ujë;
- Kanalizimit të ujërave të ndotura;
- Furnizimit të ujit me shumicë; dhe
- Tarifave e lidhjeve të reja.

Në vijim të këtij informacioni, audituesit ligjorë duhet të verifikojnë nëse janë miratuar nga ERRU-ja, nëse ka diferencim sipas zonave dhe sa është ky diferencim, si dhe të kontrollojnë një kampion të rastësishëm prej 40 rastesh, për zbatimin e këtyre tarifave gjatë gjithë periudhës, që është subjekt kontrolli.

e) Marrin informacion mbi klientët e analizuar nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve, në lidhje me numrin total të klientëve (nga të cilët sa janë klientë pa matës), si dhe shumatat e arkëtuara, grupuar sipas kategorive në vijim:

- Familjarë;
- Biznese;
- Institucione.

Në vijim të këtij informacioni, audituesit ligjorë duhet të verifikojnë nëse arkëtimet rakordojnë me librat kontabël analitikë (libri i arkës, bankës dhe/ose kartelat e klientëve), si dhe nëse numri i klientëve me dhe pa matës rakordon me numrin e njësisë, sipas projektit të adresarit;

ë) Analizojnë për kategoritë në pikën “g” më sipër, historikun e marrëdhënieve me klientët (arkëtime, faturime etj.) dhe të identifikojnë klientët që nuk kanë veprime nga 1–5 vjet dhe mbi 5 vjet, si dhe ekzistencën e klientëve pa identitet;

f) Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve, mbi:

- Prodhimin e ujit;
- Humbjet e ujit në rrjet (teknike dhe/ose administrative);
- Sasinë e ujit të shitur/faturuar;
- Investimet nga burimet e veta; si dhe

- Të verifikojnë nëse të dhënat sintetike rakordojnë me të dhënat e regjistrave përkatës analitike;

g) Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi vlerën e faturuar për bizneset, sipas kategorisë së faturimit dhe tarifës së aplikuar për çdo kategori. Gjithashtu, duhet të verifikojnë nëse vlera e faturuar rakordon me librat analitikë kontabël (p.sh., totalin e kartelave të klientëve);

gj) Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi shpenzimet operative, si dhe të verifikojnë nëse rakordojnë me kartelat analitike të kontabilitetit, duke rishikuar për keqklasifikime apo për zëra të pazakonshëm, në lidhje me kategoritë në vijim:

- Pagat bruto;
- Mirëmbajtjen dhe riparimet;
- Energjinë elektrike;
- Karburantin;
- Kimikatet;
- Shpenzime auditimi ligjor, konsulencia ligjore, tatimore, financiare dhe të tjera biznesi;
- Shpenzime të tjera operative.

Gjithashtu, audituesit ligjorë, shoqëritë e auditimit apo bashkimet e operatorëve ekonomikë duhet të llogarisin sa është totali i shpenzimeve operative;

h) Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi ankesat nga konsumatorët, të grupuara sipas natyrës së ankesës. Gjithashtu, duhet të verifikojnë numrin total të ankesave të marra, numrin e ankesave të zgjidhura, të refuzuara dhe pa përgjigje, të dhëna të cilat mbështeten në regjistrin analitik të ankesave;

i) Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi numrin total të matësve për burime dhe puse, si dhe të verifikojnë nëse rakordojnë me të dhënat analitike të regjistrave të matësve;

j) Rishikojnë mbajtjen e regjistrit për sistemet e furnizimit me ujë të ndërtuara nga qytetarët;

k) Rishikojnë nivelin e transparencës në ngritjen e mekanizmave për furnizimin me ujë të familjeve në nevojë pa pagesë, që sigurojnë të paktën 20 litër/ditë/frymë;

l) Bëjnë verifikime të tjera, që lidhen me natyrën specifike sipas së cilës operon subjekti, të cilat miratohen me urdhër të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

**URDHËR****Nr. 204, datë 30.3.2018****PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe të nenit 56, të vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Brendshme, z. Dritan Palnikaj, Sekretar i Përgjithshëm, për të gjitha procedurat e prokurimit publik të kësaj ministrie.

2. Delegimin e kompetencave për kryerjen e procedurave të prokurimit, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 82, datë 14.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, deri në fillimin e funksionimit të plotë të Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, sipas parashikimeve të vendimit nr. 81, datë 14.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara”.

3. Kompetencat, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data 30.3.2018 deri në shfuqizimin e këtij urdhri.

4. Urdhri nr. 1045, datë 18.10.2017, i ministrit të Brendshëm, “Për delegim kompetencash”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Fatmir Xhafaj

VENDIM**Nr. 10, datë 3.4.2018****NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 23.1.2018 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 68/10 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Liman Laçi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, Prefekti i Qarkut Dibër Bashkia Klos

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuës me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2017-143, datë 21.3.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/“f” dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gani Dizdari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuës, që kërkoj pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit dhe prefektit të Qarkut Dibër, që kërkojnë rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:**I**

1. Me aktin e marrjes në pronësi nr. 74, datë 20.1.1994 kërkuësit i është dhënë në pronësi një sipërfaqe toke prej 10.400 m² tokë arë, në emër të familjes bujqësore të kërkuës, Liman Laçi, në zbatim të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”.



2. Prefekti i Qarkut Dibër, bazuar në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar si dhe në udhëzimin nr. 2, datë 13.1.2010 të Këshillit të Ministrave, ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të titullit të marrjes së tokës në pronësi, pasi ka rezultuar se kërkuesi nuk ka qenë banor i fshatit Suç në datën 1.8.1991, kur ka filluar efektet ligji nr. 7501/1991.

3. Komisioni i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, me vendimin nr. 46, datë 8.11.2010, ka vendosur: “Pavlefshmërinë ligjore dhe shfuqizimin e titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore të kërkuetit.”.

4. Për konstatimin gjyqësor të këtij vendimi, prefekti i Qarkut Dibër i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e ATMP-së së kërkuetit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. 298, datë 4.10.2011, ka vendosur: “*Rrëzimin e padisë së prefektit të Qarkut Dibër.*”.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1083, datë 8.5.2012 ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit.*”.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-143, datë 21.3.2017, ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimeve të të dyja gjykatave. Pranimin e padisë, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të aktit të marrjes së tokës në pronësi.*”.

II

7. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ, duke pretenduar se ai është i padrejtë dhe antikushtetues, pasi ka cenuar të drejtën e pronësisë nëpërmjet një procesi të parregullt ligjor. Pavarësisht se ai *de jure* nuk rezulton i regjistruar në gjendjen civile të njësisë Klos në datën e hyrjes në fuqi të ligjit “Për tokën”, *de facto* ai nuk është larguar asnjëherë nga fshati dhe nuk ka pasur asnjë vendbanim tjetër jashtë tij. Vetëm fakti i lëvizjes formale të vendbanimit nuk mund t’i heqë të drejtën e pronësisë mbi tokën, të cilën ai e ka fituar sipas ligjit, pasi ka qenë prej shumë vitesh banor i atij fshati.

8. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Përgjithshme e Shtetit**, ka parashtruar se procesi i zhvilluar para Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është bërë në përputhje me rregullat procedurale dhe materiale të parashikuara për këtë qëllim. Kërkuesi nuk ka ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, por vetëm ligjore, të cilat nuk

janë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

9. **Subjekti i interesuar, prefekti i Qarkut Dibër**, ka parashtruar se pretendimet e kërkuetit nuk qëndrojnë. Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është i mbështetur tërësisht në ligj e prova dhe, si rrjedhojë, ka respektuar të gjitha elementet e procesit të rregullt ligjor.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

10. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/1/“F” dhe 134/1/“I” të Kushtetutës. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 21.3.2017, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 18.7.2017, pra brenda afatit 4-mujor, sipas nenit 71/“a”, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se bazuar në nenin 131/1/“F” të Kushtetutës ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte, çka nënkupton se kërkuesi duhet t’i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës së pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 48, datë 6.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Rezulton se kërkuesi i ka shteruar të gjitha mjetet dhe legjitimohet t’i drejtohet kësaj Gjykate për sa pretendon në kërkesë.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së pronës

12. Kërkuesi pretendon se vendimi i Kolegjit Administrativ është antikushtetues, pasi ai ka cenuar të drejtën e pronës nëpërmjet një procesi të parregullt. Ai kolegji ka interpretuar provat dhe faktet në mënyrë të ndryshme nga dy gjykatat e faktit, duke arritur në një përfundim të ndryshëm, gjë që nuk përputhet me natyrën e gjykimit të Gjykatës së Lartë.

13. Në jurisprudencë të vazhdueshme Gjykata



ka theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Referuar çështjes konkrete për gjykim, Gjykata sjell në vëmendje se ajo ka marrë më parë në shqyrtim ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” dhe ka çmuar: “Ky ligj është në pajtim me Kushtetutën vetëm nëse ai interpretohet dhe zbatohet në përputhje me parimet e theksuara prej kësaj Gjykate. Konkretisht, ai nuk prek titujt e pronësisë të dhënë në përputhje me kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi në kohën e krijimit të tyre, pasi komisionet vendore janë vetëm konstatuese të pavlefshmërisë, ato nuk mund të anulojnë apo shfuqizojnë tituj të pronësisë apo të urdhërojnë rregjistrimin e këtyre titujve nga regjistri i pasurive të paluajtshme. Është vetëm gjykata, e cila mbi padinë e të interesuarve apo autoriteteve publike përkatëse, vendos përfundimisht në lidhje me të drejtën e pronësisë së subjekteve të interesuara [...] sipas nenit 10/1 të këtij ligji, kur KV-ja, gjatë verifikimit, vëren se krijimi i titujve të pronësisë mbi tokën është bërë në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në nenet 2, 3 dhe 4 të këtij ligji, i paraqet gjykatës së rrethit gjyqësor përkatës një kërkesë për anulimin e aktit administrativ “akti i marrjes së tokës në pronësi”, dhe sipas pikës 2, të nenit 10 të këtij ligji, kërkesa i paraqitet subjektit përkatës nga prefekti dhe objekti i kërkesës së

prefektit është deklarimi i pavlefshmërisë së “aktit të marrjes së tokës në pronësi” (shih vendimin nr. 29, datë 31.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

15. Gjykata thekson se qëllimi i ligjit nr. 9948/2008 është verifikimi i titujve të pronësisë së tokave bujqësore për ligjshmërinë e tyre, në mënyrë që të shmanget marrja e pronësisë së tokës bujqësore në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga ligji nr. 7501/1991, “Për tokën” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Në ligj është parashikuar shprehimisht se kur AMTP-ja e përfituesit të tokës bujqësore shfuqizohet me vendim të gjykatës, prona e përfituar padrejtësisht duhet të kalojë në pronësi të shtetit dhe jo të mbetet në pronësi të personave të tretë.

16. Në çështjen konkrete rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe Gjykata e Apelit Tiranë kanë marrë në shqyrtim kërkesëpadinë e prefektit të Qarkut Dibër dhe kanë arritur në përfundimin se shkelja e pretenduar prej paditësit (pra, mosqenia i regjistruar në regjistrin e gjendjes civile të fshatit Suç në datën 1.8.1991) nuk është e tillë që ta bëjë absolutisht të pavlefshëm titullin e pronësisë. Të dyja gjykatat e kanë pranuar faktin se kërkuksi ka bërë transferimin e gjendjes civile dhe bashkë me të edhe të lejes së banimit në datën 7.7.1991 nga fshati Suç në qytetin Klos, pra vetëm disa javë para datës që përcakton ligji nr. 7501/1991 si afat përfundimtar për përfitimin e tokës si pjesë e familjes bujqësore, por *de facto* kërkuksi dhe familja e tij kanë vazhduar të jetojnë në fshatin Suç, gjë që provohet edhe nga fakti se fëmijët e tij kanë frekuentuar shkollën e fshatit Suç. Në këtë këndvështrim, gjykatat kanë konstatuar se ky fakt nuk është i tillë që ta bëjë AMTP-në e përfituar nga kërkuksi një akt absolutisht të pavlefshëm, pasi qëllimi i ligjit nr. 7501/1991 për t’i dhënë një anëtar të familjes bujqësore tokë rezulton i realizuar. Kërkuksi ka qenë vazhdimisht dhe pa ndërprerje banor i fshatit Suç, gjë që është vërtetuar gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe në apel.

17. Nisur nga sa më lart, Gjykata çmon se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk mund të bëjë vlerësim të ndryshëm për të njëjtat fakte nga ato që kanë bërë dy gjykatat më të ulëta, pasi kjo gjë nuk është në përputhje me juridiksionin e asaj gjykate. Gjykata është shprehur se nxjerrja e një konkluzioni të kundërt nga ana e Gjykatës së Lartë, lidhur me provat e marra gjatë gjykimit në dy gjykatat e shkallëve më të ulëta, nuk pajtohet me



natyrën e gjykimit të saj. Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë *a priori* nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta rezulton e provuar e kundërta. Nëse ajo vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo nëse çmon se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e të metave të vendimit, por në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta gjyqësore. Një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, i trajtuar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese (*shih vendimet nr. 44, datë 19.7.2016; nr. 7, datë 7.2.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Nisur nga sa më lart, Gjykata çmon se Kolegji i Gjykatës së Lartë nuk mund të ndryshojë vendimet e gjykatave të faktit dhe të shprehet për themelin e çështjes duke bërë vlerësim të ndryshëm të provave dhe fakteve që janë administruar gjatë gjykimit nga gjykatat më të ulëta. Procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtësi të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar gjatë gjykimit në fakt (*shih vendimet nr. 83, datë 30.12.2015 dhe nr. 20, datë 20.3.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Kolegji Administrativ në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel, duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit nga gjykatat më të ulëta. Një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj të zhvilluar në vazhdimësi nga Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj (*shih vendimet nr. 36, datë 30.6.2014; nr. 87, datë 30.12.2016 dhe nr. 56, datë 25.7.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka tejkalluar kompetencat ligjore, duke cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/“P” dhe 134/1/“I” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2017-143, datë 21.3.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar),
Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Besnik Imeraj,
Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Fatos Lulo

**VENDIM****Nr. 24, datë 28.3.2018****PËR DISA NDRYSHIME NË
RREGULLOREN “PËR ORGANIZIMIN
DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT
KOMBËTAR TË SISTEMIT TË
PAGESAVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, paragrafi 4, shkronja “dh”; të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 4, të ligjit nr. 133/2013, datë 29.4.2013, “Për sistemin e pagesave”, me propozimin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave”, miratuar me vendimin nr. 37, datë 25.6.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 4, pika 1, shkronja “e” ndryshon me përmbajtje si vijon:

“një ose më shumë përfaqësues në nivel ekzekutiv nga ministritë, të cilat mbulojnë funksionet në vijim, në cilësinë e anëtarit:

- i) thesarin e shtetit;
- ii) të drejtën për të propozuar akte ligjore të hartuara nga Banka e Shqipërisë;
- iii) mbrojtjen e konsumatorit;
- iv) regjistrin e gjendjes civile;
- v) luftën kundër krimit kibernetik;
- vi) inovacionin dhe digjitalizimin e shërbimeve publike (*e-government*);
- vii) dërgesat e emigrantëve;
- viii) si dhe funksione të tjera të cilat në varësi të objektivave dhe projekteve mund të ndërliken me funksionin e Komitetit.”;

b) Në nenin 4, shkronjat “f”, “g” dhe “h” shfuqizohen;

c) Në nenin 4, pas shkronjës “k” shtohet shkronja “l” me përmbajtje si më poshtë:

“një përfaqësues në nivel ekzekutiv nga institucionet financiare jobanka, të cilat kryejnë veprimtarinë e transfertave dhe pagesave dhe/ose të parasë elektronike dhe operatorët e

